



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5054/2025

A.nr.1074/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtar, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1074/2025, të parashtruar nga ankuesit- A.K, F.Ç, F.P, B.B, A.K, Z.H, R.B, A.A-H, N.G, Z.L-B., A.F, R.B, E.A të bashkuara me Vendimin e datës 20.06.2025 nr. Vk/2025, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1074/2025, të bashkuara me vendimin VK/2025 të datës 20.06.2025 e parashtruar nga ankuesit **A.K, F.Ç, F.P, B.B, A.K, Z.H, R.B, A.A-H, N.G, Z.L-B., A.F, R.B** dhe **E.A**, ashtu që **detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesave të datës 15.04.2025; kërkesën e datës 20.03.2025; kërkesën e datës 18.03.2025; kërkesën e datës 20.03.2025; kërkesën e datës 20.03.2025; kërkesën e datës 21.03.2025; kërkesën e datës 20.03.2025; kërkesën e datës 20.03.2025; kërkesën 20.03.2025; kërkesën e datës 20.03.2025 dhe kërkesën e datës 20.03.2025 dhe kërkesën e datës 15.04.2025 të parashtruar nga ankuesi e lartshënuar, dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

II. Hidhet poshtë e pa lejuar ankesa A.nr. 1025/2025, e datës 30.05.2025, e parashtruar nga ankuesja Z.L-B.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, të lartshënuar, (ankesa është bashkuar me vendimin VK/2025 të datës 20.06.2025). (në tekstin e mëtejme referuar: Ankueseve), me datë 20.06.2025 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në kërkesat e datave si vijon:

15.04.2025,20.03.2025,18.03.2025,20.03.2025,20.03.2025,21.03.2025,20.03.2025,20.03.2025,20.03.2025,20.03.2025,20.03.2025,15.04.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 18.06.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesa së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli An. Anr. 1074/2025 të datës 04.06. 2025, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimet me Nr. 01-112-1223 të datës 16.11.2024; nr.01-112-1320; Nr.01-112-32; nr. 01-112-1174; nr. 01-112-687; nr. 01-112-652; 01-112- 1015; nr. 01-112-1168; nr. 01-112-712; nr. 01-112-127; nr. 01-112-543; Kopjen e ID-së së ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë e datës 11.06.2025.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesve, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datave të lartshënuara parashtruar nga ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesit sipas Akt Emërimeve të lartshënuara 8 prej tyre janë të punësuar në pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile”, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, ndërsa 3 prej tyre janë të punësuar në pozitën “ Zyrtar për Shërbime me Qytetar”, organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Prishtinës sipas nenit 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me datë 16.11.2024 8 ankuesve që kanë pozitë “Zyrtar të Gjendjes Civile” iu ka lëshuar Aktin e Emërimit me Akt Emërimit nr.01-112-1320 me të datës 16.11.2024;; Nr.. 01-112-32; nr. 01-112-1174; nr. 01-112-687; 01-112- 1015; nr. 01-112-1168; nr. 01-112-712; nr. 01-112-127; , ashtu që pozitën e ankueses “Zyrtar për Gjendje Civile”, ndërsa tre ankues me pozitën “Zyrtar për Shërbime me Qytetar” iu është lëshuar akt emërimi nr. 01-112-1223; nr. 01-112-652 dhe nr. 01-112-543 të gjithë ankuesit e lartpërmendur janë klasifikuar në Kategorinë Profesional klasa profesional 2, me koeficient të pagës, GJ33, 5.1.

Ankuesi, sipas kërkesave të shënuar në dispozitiv i janë drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesën, për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuara Aktit të Emërimit të lëshuar datë 16.11.2024. Po ashtu ankuesit në kërkesën në fjalë pretendojnë se janë duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4 Profesional 3, ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet fakti se organi i punësimit ka heshtur lidhur në kërkesën e ankuesëve të shënuara si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se të njëjtit janë duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient 5.1, të njëjtit nuk janë duke u kompensuar sipas koeficientit të ri, e me kërkesë që organi i punësimit të zbatoj aktin e emërimit me Nr. 01-112-99 të datës 16.11.2024 dhe ti kompensojë sipas koeficientit 5.1 duke përfshirë kompensimin në mënyrë retroaktive që nga data 16.11.2024. Kërkojnë që të aprovohet ankesa dhe

të obligohet Komuna e Prishtinës të zbatoj akt emërimet e datës 16.11.2024 dhe kompensimin sipas koeficientit 5.6 nga dita e nënshkrimit të akt emërimit.

Këshilli në kërkesën për përgjigje në ankesë, ndër tjerash kishte kërkuar prova dhe sqarime nga Komuna e Prishtinës, si në vijim: *“Dëshmi se a ka pasur klasifikim të vendeve të punës në Komunën e Prishtinës”*, kurse kjo e fundit në kërkesën e përcjellë me datë 11.06.2025 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, nuk kishte dhënë asnjë sqarim lidhur me kërkesën e cekur si më lartë.

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, meqenëse palët ankuese, kanë parashtruar kërkesë sipas datave të shënuar në dispozitiv të këtij vendimi, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, atëherë Kolegji i Këshillit, lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj kërkesën e palës dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *“3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar”*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”*, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”*, dhe për rrjedhojë konstatoi, se organi të cilit i është drejtuar kërkesa, në rrethanat e rastit konkret Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh, apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesat e palëve ankuese nuk janë shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtroj ankesë tek organi i shkallës më të lartë kundër heshtjes administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj kërkesës së ankuses, ankesa e ankuses e datës 22.05.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga palët ankuese të përfshira në këtë vendim, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palëve ankuese

dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, gjatë shqyrtimit të kërkesave të palëve ankuese, duhet ta shqyrtoj faktin nëse akti mbi bazën e të cilit ankuesit i ka ngritur pretendimet për kompensim material, është lëshuar në pajtim me dispozitat e ligjit material, respektivisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Ndërsa, në piken 2, të këtij dispozitive, Kolegji i këshillit vendosi të Hidhet poshtë si të pa lejuar ankesa A.nr. 1025/2025, e datës 30.05.2025, të parashtruar nga ankuesja Z.L–B, sepse;

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës se ankueses Z.L–B, iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore konstatoi se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës*, mirëpo kur kemi të bëjmë me realizimin e të drejtave sikurse në rrethanat e rastit konkret, nëpunësi civil fillimisht duhet t'i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës se pretenduar, dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo heshtjes se organit publikë në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtroj ankesë, sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht përgjigjes në ankesë të organit të punësimit, ka konstatuar se ankuesja për realizimin e pagës jubilarë, për çka edhe ka parashtruar ankesë, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, gjegjësisht Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Prishtinës, veprim ky i domosdoshëm për inicimin e procedurës administrative sipas dispozitave të ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Si rrjedhojë, në mungesë të kërkesës se parashtruar të organi i punësimit për realizimin e të drejtës se pretenduar, nga ankuesja, në rastin konkret nuk kemi objekt trajtimi ngase mungon veprimi apo mosveprim nga organi i punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se ankuesja nuk ka parashtruar kërkesë të organi përkatës i punësimit Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv e 2 të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.1074/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueseve; A.K, F.Ç, F.P, B.B, A.K, Z.H, R.B, A.A-H, N.G, Z.L-B., A.F, R.B, E.A.;
- Komunës së Prishtinës (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.;